

RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	
EMËRTIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS	Projektligj “Për krijimin, mbajtjen dhe menaxhimin e rezervave minimale të sigurisë të naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”
MINISTRIA UDHËHEQËSE	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE)
FAZA E POLITIKËS/VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	Final
BURIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS	Transpozim direktive
DIREKTIVË/RREGULLORE E BE-së	Direktiva 2009/119/KE e Parlamentit Europian dhe të Këshillit, datë 14 shtator 2009, ”Mbi vendosjen e detyrimit tek Vendet Anetare për mbajtjen e rezervës minimale të sigurisë për naftën dhe/ose nënproduktet e saj”, ndryshuar me direktivën 2018/1581 date 19.tetor 2018 dhe Rregulloren 2018/1999, date 11 Dhjetor 2018”
PUBLIKIMET DHE STRATEGJITË E LIDHURA	Strategjia Kombetare e Energjise e miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 480, datë 31.7.2018 “Për miratimin e strategjisë kombëtare të energjisë për periudhën 2018–2030” Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 818, datë 26.12.2024 “Për miratimin e programit të përgjithshëm analitik të projektakteve që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave gjatë vitit 2025” . Vendimin nr. 16, datë 11.1.2024, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Planit Kombëtar për Integrimin Evropian 2024–2026”.
DATA E KONSULTIMIT PUBLIK	6.10.2025-3.11.2025
DATA E VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	
A E KA SHQYRTUAR KRYEMINISTRIA VLERËSIMIN E NDIKIMIT? NËSE PO, JEPNI DATËN E SHQYRTIMIT	Jo
NUMRI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	
TE DHËNA KONTAKTI (EMRI, E-MAIL, NUMRI I TELEFONIT TË PERSONIT TË KONTAKTIT)	

PJESA 1: PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

(Maksimumi 2 faqe)

PËRKUFIZIMI I PROBLEMIT

Cili është problemi në shqyrtim dhe cilat janë shkaqet e tij? Pse është e nevojshme ndërhyrja qeverisë?

Referuar kuadrit ligjor ekzistues, ligjit aktual nr. 8450, datë 14.02.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar, i cili trajton aktualisht në nenin 9 të tij çështjet e rezervës së sigurisë, nuk është në përputhje me Direktivën 2009/119/EC.

Vendi ynë, si anëtar i Traktatit të Komunitetit të Energjisë, ka pasur detyrimin të transpozojë Direktivën e Këshillit Evropian 2009/119/EC në legjislacionin shqiptar, për mbajtjen dhe menaxhimin e rezervës së sigurisë për naftën, si dhe kërkesat e MSA-së, PKIE-së dhe dokumenteve të tjera të sektorit të energjisë, ku parashikohet transpozimi në ligj i kësaj Direktivë, përfshirë edhe ndryshimet më të fundit të bëra me Rregulloren 2018/1999.

Duke marrë në konsideratë sa më sipër, Shqipëria ndodhet në një situatë ku aktiviteti për mbajtjen dhe menaxhimin e rezervës së sigurisë për naftën nuk është i rregulluar në përputhje me legjislacionin e Bashkimit Evropian. Ky fakt përbën një pengesë të rëndësishme për procesin e anëtarësimit në BE, i cili mbetet një ndër prioritetet strategjike kryesore të vendit.

Adresimi i këtyre problematikave është i domosdoshëm për të siguruar harmonizimin me *acquis communautaire* të BE-së, si dhe për të rritur sigurinë e furnizimit me burime energjetike hidrokarbure për tregun vendas dhe më gjerë.

Aktualisht, përveç faktit që legjislacioni nuk është në përputhje me atë të Bashkimit Evropian, edhe shoqëritë që tregtojnë karburante me shumicë dhe rafineritë e naftës, të cilat kanë detyrim për mbajtjen e rezervave të sigurisë, nuk kanë asnjë stimul financiar apo rregullator për të mbajtur këto rezerva. Si pasojë, mungon një mekanizëm që të nxisë dhe detyrojë mbajtjen e rezervave të sigurisë.

Në këtë kontekst, Shqipëria rrezikon të mos arrijë objektivat kombëtare dhe ndërkombëtare për mënyrën e llogaritjes, raportimit dhe përdorimit të rezervave të sigurisë për naftën dhe nënproduktet e saj, veçanërisht ato të përcaktuara në kuadër të Komunitetit të Energjisë.

OBJEKTIVAT

Cilat janë objektivat dhe efektet e synuara të propozimit?

1. **Të përcaktojë detyrimet** për mbajtjen dhe menaxhimin e rezervave të sigurisë për naftën bruto dhe nënproduktet e saj, me qëllim sigurimin e një niveli të lartë të sigurisë së furnizimit në Republikën e Shqipërisë.
2. **Të përcaktojë procedurat** për krijimin, mbajtjen dhe menaxhimin e rezervave të sigurisë së naftës dhe nënprodukteve të saj, si dhe përdorimin e tyre në rast të reduktimit të papritur ose mungesës së furnizimit të tregut. Ky objektiv është në përputhje dhe harmonizim të plotë me praktikën e shteteve anëtare të Bashkimit Evropian dhe të Komunitetit të Energjisë, në rastet e krijimit të situatave të jashtëzakonshme.
3. **Të krijojë strukturën përgjegjëse** për mbajtjen dhe menaxhimin e rezervave të sigurisë për naftën bruto dhe nënproduktet e saj, duke garantuar funksionimin e saj në përputhje me standardet dhe kërkesat e BE-së.
4. **Të krijojë kuadrin ligjor** për përcaktimin e detyrimeve lidhur me llojin, afatet, metodologjinë e përpunimit dhe raportimit të të dhënave që lidhen me rezervat e naftës, në përputhje me standardet e Bashkimit Evropian.

OPSIONET E POLITIKAVE

Cilat janë opsionet kryesore të politikave, duke përfshirë mënyrat ndaj rregullimit? Duhet të bëni krahasimin e avantazheve/përfitimeve kryesore dhe të dizavantazheve/kostove të opsioneve të mundshme. Duhet të përcaktoni detajet në lidhje me opsionin e preferuar.

Opsioni 0 – Status quo-ja:

Nëse mbetemi në situatën aktuale, pra me lënien në fuqi të ligjit ekzistues nr. 8450, datë 14.02.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar, atëherë kjo do të thotë se nuk do të merret në konsideratë nevoja për harmonizimin e kuadrit ligjor shqiptar me Direktivën 2009/119/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 14 shtator 2009, “Mbi vendosjen e detyrimit për vendet anëtare për mbajtjen e rezervës minimale të sigurisë për naftën dhe/ose nënproduktet e saj”, ndryshuar me Direktivën 2018/1581, datë 19 tetor 2018, dhe Rregulloren 2018/1999, datë 11 dhjetor 2018.

Opsioni 1 (rregullator):

Ky opsion parashikon hartimin e një ligji të ri, duke marrë parasysh të gjitha ndryshimet dhe kërkesat e kuadrit ligjor të BE-së, sa i përket realizimit të aktivitetit të mbajtjes dhe menaxhimit të rezervave të sigurisë për naftën dhe nënproduktet e saj, mënyrës dhe afateve kohore për raportimin e të dhënave të krijuara nga këto aktivitete në Republikën e Shqipërisë.

Opsioni 2 – Ndryshimi i ligjit aktual:

Kryerja e ndryshimeve në ligjin aktual në fuqi nr. 8450, datë 14.02.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar, nuk

është e favorshme për shkak se do të krijonte konfuzion në zbatim, pasi shumë norma të tij nuk janë më koherente. Duke qenë se direktiva e BE-së, sa i takon aktivitetit të mbajtjes dhe menaxhimit të rezervave të sigurisë, do të transpozohet në 100% të saj, dhe ndryshimet që do të bëheshin në ligjin aktual do të ishin të konsiderueshme nga ana e teknikës legjislative, nuk do të ishte efikase kryerja e ndryshimeve dhe, për rrjedhojë, e pamundur ndërmarrja e një nisme të tillë.

Opsioni 3 – Hartimi dhe miratimi i akteve nënligjore në zbatim të ligjit në fuqi:

Miratimi i akteve nënligjore nuk është i favorshëm, për shkak se ky opsion nuk do të mundësonte përafrimin e legjislacionit të Bashkimit Evropian, pasi autorizimet ligjore për nxjerrjen e akteve nënligjore janë të bazuara në një direktivë të shfuqizuar nga Bashkimi Evropian.

Opsioni 4 – Jo-rregullator:

Një opsion jo-rregullator për zgjidhjen e problematikave, ku nuk është përcaktuar detyrimi për mbajtjen dhe menaxhimin e rezervave të sigurisë në sasi dhe lloje burimesh energjetike, nuk mund të realizohet. Kjo referuar eksperiencës së të gjitha vendeve të BE-së, dhe nuk ka asnjë argument financiar për të mbështetur këtë opsion.

ANALIZA E NDIKIMEVE

Cilat janë ndikimet e opsionit të preferuar? Kjo duhet të përfshijë ndikimet me vlerë monetare të përcaktuar dhe ndikimet pa vlerë monetare të përcaktuar mbi buxhetin dhe bizneset.

Grupet e prekura nga kjo politikë do të jenë:

1. **Operatorët** që operojnë në sektorin e rafinimit dhe tregtimit të naftës bruto dhe nënprodukteve të saj.
2. **Shoqatat dhe grupet e interesit** të industrisë së hidrokarbureve.
3. **Institucionet publike:**
 - **Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë**, përgjegjëse për hartimin dhe ndjekjen e zbatimit të politikave.
 - **Ministria e Financave**, për hartimin dhe miratimin e paketave të përshtatshme ligjore në sistemin fiskal të Republikës.
 - **Autoriteti për Rezervën e Sigurisë**, përgjegjës për krijimin, mbajtjen dhe përdorimin e rezervave të sigurisë.
 - **Inspektorati Shtetëror**, i specializuar për kontrollin e veprimtarisë.
 - **Drejtoria e Përgjithshme e Doganave**, përgjegjëse për grumbullimin e detyrimeve financiare sipas modelit të përcaktuar.
 - **INSTAT**, përgjegjës për informimin e strukturave që përcaktohen në këtë ligj.
4. **Sektori privat:**
 - Kompanitë që realizojnë aktivitetin e prodhimit dhe importit të naftës dhe nënprodukteve të saj.
5. **Qytetarët:**
 - Përdoruesit e mjeteve të transportit.

Ndikimet pozitive nga kjo politikë lidhen me:

- Përafrimin e legjislacionit me atë të Bashkimit Evropian.
- Rregullimin e tregut të hidrokarbureve në përputhje me standardet evropiane.

Kostot për sektorin publik:

- Rritja e kapaciteteve të burimeve njerëzore dhe infrastrukturës për mundësimin e zbatimit të kësaj politike.
- Përshtatja me kërkesat e reja ligjore dhe teknike.
- Mbledhja dhe përpunimi i të dhënave të paraqitura nga subjektet private.
- Kryerja e inspektimeve nga Ministria, Autoriteti për Rezervën e Sigurisë (ARS), Inspektorati Shtetëror përgjegjës dhe strukturat e tjera përgjegjëse për monitorimin.

Kostot për bizneset:

- Parashikohen të jenë minimale dhe lidhen kryesisht me tarifat financiare, pasi këto do të paguheshin menjëherë dhe do të mbledhen vetëm pasi produkti të jetë shitur për konsumatorin final.
- Propozimi i politikës do të sjellë kosto administrative për shoqëritë që do të duhet të respektojnë kërkesat e reja.
- Kostoja për plotësimin e standardeve të kërkuara, kushteve dhe parametrave të sigurisë, si p.sh. blerja apo ndërtimi i objekteve të reja të magazinimit.

ARSYETIMI I OPSIONIT TË PREFERUAR

Shpjegoni arsyet për zgjedhjen e opsionit të preferuar. Ju lutemi jepni nëse është e mundur koston dhe përfitimin me vlerë të përcaktuar monetare.

Opsioni i rekomanduar/i preferuar, bazuar edhe në analizën me shumë kritere, është Opsioni 1 – hartimi i një ligji të ri, pasi ky opsion realizon në mënyrë të plotë kërkesat për përafrimin me kuadrin ligjor të Bashkimit Evropian, në lidhje me aktivitetin e mbajtjes dhe menaxhimit të rezervave të sigurisë për naftën dhe nënproduktet e saj në Republikën e Shqipërisë.

Ky opsion bën të mundur arritjen e një objektivi konkret të Qeverisë Shqiptare, që lidhet me mbajtjen dhe menaxhimin e rezervës së sigurisë për naftën bruto dhe nënproduktet e saj, me qëllim sigurimin e një niveli të lartë të sigurisë së furnizimit për tregun vendas. Gjithashtu, ky mekanizëm kontribuon edhe për tregun evropian, duke qenë se Shqipëria ndikohet dhe ndikon në tregun rajonal në rastet e krizave të furnizimit me nënprodukte energjetike hidrokarbure.

Kjo arrihet pikërisht sepse në ligjin e ri përcaktohen procedurat e nevojshme që duhet të ndiqen për përdorimin e rezervave të sigurisë në rast të reduktimit të papritur, deri në mungesë, të furnizimit të tregut me nënprodukte të naftës bruto.

Gjithashtu, ky opsion siguron bazën e nevojshme ligjore për:

- Përcaktimin e metodikave të grumbullimit të të dhënave mbi prodhimin, importin dhe konsumimin e lëndëve energjetike hidrokarbure;
- Përpunimin dhe raportimin e tyre, në përputhje me kërkesat e legjislacionit të Bashkimit Evropian.

Kostoja e përlllogaritur në total e opsionit të preferuar mbi buxhetin e shtetit gjatë periudhës 3-vjeçare menjëherë pas miratimit të ligjit (kostoja në total në lek, çmimet aktuale, në terma nominalë):

Viti 1	Viti 2	Viti 3
Nuk aplikohet	Nuk aplikohet	Nuk aplikohet

KONSULTIMI

Jepni një përmbledhje të çdo konsultimi të kryer (me kë dhe si jeni konsultuar?), çfarë pikëpamjesh janë shprehur, si janë trajtuar ato, domethënë çfarë ndryshimesh janë pranuar dhe çfarë janë refuzuar dhe arsyet pse?)

Projektligji nuk është publikuar ende në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike, si në nivel eksperti ashtu edhe qytetari. Megjithatë, në përputhje me procedurat përkatëse që lidhen me miratimin e një akti ligjor, publikimi i tij është i detyrueshëm dhe do të realizohet me qëllim marrjen e opinioneve përkatëse nga grupet e interesit dhe publiku i gjerë.

ZBATIMI DHE MONITORIMI

Si do të organizohen zbatimi dhe monitorimi?

Për të mundësuar zbatimin e këtij ligji, do të angazhohen disa institucione kyçe, si:

- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), si institucion politikbërës, do të hartojë dhe ndjekë zbatimin e politikave në sektorin e garantimit të furnizimit me burime energjetike për tregun vendas, si dhe lidhjen e tij me vendet e rajonit dhe të Bashkimit Evropian.
- MIE, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave, do t'i propozojë Këshillit të Ministrave caktimin e tarifës për krijimin dhe mbajtjen e rezervës së sigurisë, e cila aplikohet mbi sasisë e produkteve energjetike hidrokarbure që i nënshtrohen detyrimit për pagimin e taksës së akcizës, në përputhje me Ligjin Nr. 61/2012, datë 24.05.2012 “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë do të ketë për detyrë hartimin e një sërë aktesh nënligjore që lidhen me:

- Metodat e llogaritjes, përbërjen e rezervave të sigurisë dhe procedurat për mbajtjen e rezervës minimale të sigurisë për naftën dhe/ose nënproduktet e saj;
- Metodologjinë e grumbullimit, ruajtjes, përpunimit dhe raportimit të të dhënave;
- Planin e veprimit për krijimin e rezervave të sigurisë;
- Krijimin, mënyrën e funksionimit dhe kompetencat e detajuara të Autoritetit për Rezervën e Sigurisë (ARS);
- Krijimin dhe mbajtjen e rezervave specifike;
- Planin Kombëtar të Reagimit në rast krizash të furnizimit.

Autoriteti për Rezervën e Sigurisë (ARS) do të jetë përgjegjës për:

- Krijimin, mbajtjen dhe përdorimin e rezervave të sigurisë.
- përpilimin e raporteve me të dhënat të mbedhura nga veprimat në tregun hidrokarbure dhe informimin e strukturave perkatese vendase dhe të BE me to.
- siguron mbështetje profesionale për Ministrinë sa lidhet me rezervat e sigurisë.

Institucionet e tjera të angazhuara në zbatimin e ligjit për rezervat e sigurisë për naftën dhe nënproduktet e saj përfshijnë:

- **Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial**, i specializuar për kontrollin e veprimtarisë së ushtruar nga personat juridikë, në përputhje me masat e vendosura në ligj dhe aktet nënligjore përkatëse.
- **Drejtoria e Përgjithshme e Doganave**, e cila është përgjegjëse për:
 - Dërgimin e informacionit mbi aktivitetin e të gjithë operatorëve në industrinë hidrokarbure;
- **INSTAT** (Instituti i Statistikave) është përgjegjës për informimin e strukturave të përcaktuara në këtë ligj me të dhëna të detajuara që lidhen me bilancin energjetik në Republikën e Shqipërisë. INSTAT do të bashkëpunojë me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave (DPD) dhe Autoritetin për Rezervën e Sigurisë (ARS) për sigurimin dhe përpunimin e informacionit të nevojshëm, në përputhje me përcaktimet e ligjit dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

PJESA 2: BAZA KRYESORE E ANALIZËS DHE E PROVAVE

Historik

☐ *Jepni kontekstin e politikës*

Baza Ligjore dhe Nevoja për Përafrim me Legjislacionin e BE-së

Në Republikën e Shqipërisë, baza ligjore për rezervat e sigurisë është përcaktuar në nenin 9 të ligjit nr. 8450, datë 24.02.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar me ligjin nr. 9218, datë 08.04.2004, i cili i dedikohet rezervës së sigurisë. Në zbatim të këtij ligji janë miratuar:

- VKM nr. 808, datë 05.11.2004, “Për mbajtjen dhe menaxhimin e rezervës së sigurisë për naftën, gazin dhe nënproduktet e tyre”, ndryshuar me VKM nr. 914, datë 29.12.2007;
- Urdhri i Ministrit nr. 389, datë 25.11.2014, “Për informacionet dhe të dhënat që duhet të dërgohen nga subjektet që veprojnë në fushën e përpunimit, transportimit dhe tregtimit të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”.

Këto akte përcaktojnë në mënyrë të detajuar aktivitetet për krijimin e rezervave të sigurisë sipas nënprodukteve, mënyrat e raportimit dhe procedurat që duhet të ndiqen në rast përdorimi të tyre.

Mospërputhja me Legjislacionin e BE-së

Kuadri ligjor aktual shqiptar është i përafër me Direktivën 98/93/EC, e cila ndryshonte direktivën 68/414/EC për “emergency oil stock”. Megjithatë, kjo direktivë është shfuqizuar nga Direktivën 2009/119/EC të Këshillit Evropian, e cila është aktualisht në fuqi dhe vendos detyrimin për mbajtjen e rezervës minimale të naftës bruto dhe/ose produkteve hidrokarbure.

Direktiva e re sjell ndryshime të rëndësishme, përfshirë:

- Llojet e nënprodukteve për të cilat duhet të mbahet rezervë sigurie;
- Mënyrën e llogaritjes së sasive përkatëse;
- Delegimin e detyrimit për mbajtjen e rezervës;
- Përqindjen e sasisë së naftës bruto kur ajo prodhohet në vend;
- Mënyrën e mbledhjes së të dhënave dhe raportimit.

Detyrimi për Transpozim dhe Procesi Institucional

Shqipëria, si anëtare e Traktatit të Komunitetit të Energjisë, ka detyrimin për transpozimin e Direktivës 2009/119/EC në legjislacionin kombëtar. Sipas vendimit të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, zbatimi i saj duhej të kishte filluar më 1 janar 2024.

Për këtë qëllim, Grupi Ndërinstitucional i Punës, i ngritur me Urdhrin e Kryeministrit nr. 233, datë 02.12.2013, finalizoi projektligjin, i cili u dërgua për marrje mendimi në tetor 2018. Procedura për miratimin nga Këshilli i Ministrave filloi më 30 korrik 2022. Pas reflektimit të komenteve, projektligji u ridërgua për koordinim me ministritë e linjës dhe Autoritetin e Konkurrencës.

Megjithatë, mosdakordësia me palët e interesuara (Ministria e Drejtësisë, Ministria e Financave, kompanitë e shitjes me shumicë) për modelin e mbajtjes së rezervës së sigurisë çoi në ndërprerjen e procedurës, e cila pritet të rifillojë në një fazë të re.

Angazhimi për Përafrim dhe Siguri Energetike

Referuar detyrimeve të MSA-së, PKIE-së dhe dokumenteve strategjike të sektorit të energjisë, ku parashikohet transpozimi i Direktivës 2009/119/EC, MIE ka përgatitur projektligjin e ri. Ky kuadër ligjor synon të:

- Përcaktojë detyrimet për krijimin, mbajtjen dhe menaxhimin e rezervave të sigurisë për naftën bruto dhe nënproduktet e saj;
- Sigurojë një nivel të lartë të sigurisë së furnizimit për tregun vendas;
- Rrisë koordinimin dhe bashkëpunimin me Komisionin Evropian dhe Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë;
- Mbështesë integrimin e Shqipërisë në BE përmes përafrimit me Acquis të BE-së.

Problemi në shqyrtim

- ***Përshkruani natyrën e problemit.***
- ***Identifikoni shkaqet e problemit.***
- ***Përshkruani shtrirjen e problemit.***
- ***Identifikoni grupet e prekura nga ky problem - qeveria / biznesi / shoqëria civile / qytetarët.*** □ ***Vlerësoni nëse problemi mund të trajtohet ose jo përmes një ndryshimi të politikave.***

Mospërputhja e Kuadrit Ligjor me Legjislacionin e BE-së

Referuar kuadrit ligjor ekzistues, ligji nr. 8450, datë 14.02.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar, trajton çështjet e rezervës së sigurisë në nenin 9, por nuk është në përputhje me Direktivën 2009/119/EC të Këshillit Evropian.

Shqipëria, si anëtare e Traktatit të Komunitetit të Energjisë, ka detyrimin për transpozimin e kësaj directive në legjislacionin kombëtar, në përputhje me kërkesat e MSA-së, PKIE-së dhe dokumenteve të tjera strategjike të sektorit të energjisë. Kjo përfshin edhe ndryshimet e fundit të bëra me Rregulloren 2018/1999.

Pasojat e Mungesës së Përafrimit

Aktualisht, aktiviteti për mbajtjen dhe menaxhimin e rezervës së sigurisë nuk është i rregulluar sipas standardeve të BE-së, çka përbën një pengesë të rëndësishme për procesin e anëtarësimit në BE, një ndër prioritetet strategjike të Shqipërisë.

Kjo situatë ka sjellë:

- Mungesë të mekanizmave stimulues financiarë dhe rregullatorë për shoqëritë që tregtojnë karburante me shumicë dhe rafineritë e naftës;

- Rrezik për mosarritjen e objektivave kombëtare dhe ndërkombëtare, veçanërisht atyre të përcaktuara në kuadër të Komunitetit të Energjisë;
- Hendek ligjor dhe operacional, që pengon zbatimin efektiv të standardeve të BE-së;
- Paqartësi për operatorët ekonomikë dhe institucionet zbatuese, duke ulur besueshmërinë dhe efikasitetin e sistemit.

Mangësitë në Infrastrukturën Ligjore dhe Institucionale

- Rezerva e sigurisë nuk llogaritet sipas sasisë së importuar, rafinuar apo konsumuar, por vetëm sipas sasisë së shitur, duke krijuar rritje artificiale për shkak të rishitjeve ndërmjet subjekteve të tregtimit me shumicë.
- Mungesë e formulareve standard, metodologjive të përpunimit dhe raportimit të të dhënave.
- Angazhimi i pamjaftueshëm institucional, përfshirë mungesën e një strukture të dedikuar për menaxhimin e rezervës së sigurisë me kohë të plotë.
- Frekuencë e ulët e raportimit, aktualisht një herë në vit, ndërkohë që praktikatat më të mira kërkojnë raportim mujor dhe monitorim të vazhdueshëm.

Ndikimet për Qeverinë dhe Operatorët Ekonomikë

Për qeverinë:

- Vështirësi në realizimin e politikave dhe planeve kombëtare në përputhje me kërkesat e BE-së.
- Moszbatimi i ligjit minon përpjekjet për zhvillim të qëndrueshëm dhe përputhje me *acquis communautaire*.

Për operatorët ekonomikë:

- Mungesë e kuadrit ligjor të qartë për zhvillimin e aktivitetit të mbajtjes së rezervave të sigurisë.
- Mungesë e stimuljeve për investime në teknologji të reja dhe produkte të qëndrueshme.

Rreziqet në Rast Krize dhe Mospërputhje Ligjore

- Pasiguri në zinxhirin e furnizimit me naftë bruto dhe nënprodukte.
- Operim i paqartë dhe jo i rregulluar i tregut vendas.
- Barriera për bashkëpunim ndërkombëtar, për shkak të mospërputhjes me direktivat e BE-së.

- *Shpjegoni pse qeveria planifikon të ndërhyjë dhe pse është e nevojshme.*
- *Shpjegoni se çfarë shpreson të trajtojë qeveria nëpërmjet kësaj ndërhyrjeje.*
- *Identifikoni shkallën e ndërhyrjes së qeverisë që nevojitet për të trajtuar problemin.*
- *Shpjegoni se si i mbështet kjo ndërhyrje objektivat e nivelit të lartë të qeverisë.*
- *Rendisni punën ekzistuese që është realizuar tashmë.*

Shqipëria, si anëtare e Traktatit të Komunitetit të Energjisë dhe në kuadrin e Acquis, ka detyrimin për të plotësuar kuadrin ligjor në përputhje me legjislacionin e BE-së. Në këto kushte, Qeveria Shqiptare duhet të marrë masat për të ndërhyrë dhe rregulluar kuadrin ligjor në lidhje me çështjet që kanë të bëjnë me mbajtjen dhe menaxhimin e rezervës së sigurisë për naftën dhe nënproduktet e saj.

Qeveria Shqiptare planifikon të ndërhyjë për të adresuar sfidat ekzistuese në rregullimin e këtij sektori, duke pasur parasysh disa faktorë kyç:

1. Përputhshmërinë dhe përafrimin me legjislacionin e BE-së. Si anëtare e Traktatit të Komunitetit të Energjisë dhe aspirante për anëtarësim në Bashkimin Evropian, Shqipëria ka detyrimin për të harmonizuar kuadrin ligjor me acquis-in e BE-së, pasi mungesa e kësaj përputhshmërie mund të përbëjë pengesë serioze në procesin e anëtarësimit.
2. Marrja e masave në rast të ndërprerjes së madhe të furnizimit të tregut me naftë bruto ose nënproduktet e saj, nëpërmjet Planit Kombëtar të Reagimit, i cili do të përmbajë procedura dhe kriteret për përcaktimin e ndërprerjeve të furnizimit, kompetencat dhe përgjegjësitë për masat që duhet të merren me synim eliminimin e ndërprerjes së furnizimit dhe procedurat për normalizimin e furnizimit në tregun shqiptar.
3. Bashkëpunimi dhe mbështetja nga partnerët lokalë dhe më gjerë për përballimin e situatave të jashtëzakonshme. Në kuadër të Programit të Reagimit do të përfshihen gjithashtu veprime në rast të një vendimi ndërkombëtar për vendosjen e rezervave të detyrueshme në treg.
4. Mënyra e mbajtjes së rezervës së sigurisë në Shqipëri aktualisht është e përcaktuar si detyrim vetëm i industrisë, që natyrshëm kërkon alokime të konsiderueshme financiare nga ana e subjekteve që janë të detyruara të mbajnë rezervën e sigurisë, e cila ka efekt të drejtpërdrejtë në sigurimin e mjeteve të nevojshme financiare për ecurinë e mëtejshme të biznesit të tyre.
5. Krijimi i një strukture të veçantë që të merret vetëm me çështjet e menaxhimit të rezervës së sigurisë me kohë të plotë. Kjo do të mundësojë realizimin dhe monitorimin e të gjithë zinxhirit të procesit të mbajtjes dhe menaxhimit të rezervës së sigurisë, edhe për grumbullimin e të dhënave më të sakta, me afate kohore më të shpeshta, jo një herë në vit, por çdo muaj, sikundër është edhe eksperiencia më e mirë e vendeve anëtare të Traktatit të Komunitetit të Energjisë. Gjithashtu, do të kontrollohej rezerva e sigurisë gjatë gjithë vitit.

Nëpërmjet kësaj ndërhyrjeje, qeveria synon të arrijë objektiva të rëndësishme:

1. Përbushjen e angazhimeve ndërkombëtare dhe arritjen e objektivave kombëtare për përdorimin e burimeve të rinovueshme dhe reduktimin e emetimeve të gazeve serrë për transportin.
2. Garantimin e reagimit në kohë dhe minimizimin e problematikave që mund të dalin gjatë periudhave të ndërprerjes së furnizimit të tregut vendas me naftë dhe nënproduktet e saj.

Shkalla e ndërhyrjes së qeverisë që nevojitet për të trajtuar problemin:

Kjo ndërhyrje kërkon një qasje gjithëpërfshirëse, e cila përfshin politika të qarta, angazhim institucional dhe bashkëpunim ndërsektorial për të arritur objektivat e synuara.

Plani Kombëtar për Integrimin Evropian 2024–2026 ka si synim të adresojë, përmes masave të politikës (dokumenteve strategjike) dhe ligjore, institucionale dhe zbatuese, linjëzimin e kuadrit rregullator vendas me korpusin ligjor të BE-së, si dhe zbatimin efektiv të tij.

Në listën e akteve të propozuara që i bashkëlidhet planit, dhe pjesë e akteve ligjore të miratuara me VKM nr. 16, datë 11.01.2024 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Planit Kombëtar për Integrimin Evropian 2024–2026”, miratimi i ligjit “Për krijimin, mbajtjen dhe menaxhimin e rezervave minimale të sigurisë të naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” është një nga detyrat që duhet realizuar brenda vitit 2025.

Objektivi i politikës

- *Vendosni objektiva që korrespondojnë me problemin dhe shkaqet e tij.*
- *Sigurohuni që objektivat janë specifike, të matshëm, të arritshëm, realë dhe në kohë.*

Objektivi kryesor i kësaj politike është përcaktimi i rregullave që synojnë sigurimin e një niveli të lartë të sigurisë së furnizimit me naftë bruto e nënproduktet e saj në vend, nëpërmjet mekanizmave të besueshëm dhe transparentë.

Kjo do të jetë e mundur, duke ruajtur rezervat minimale të naftës bruto dhe/ose produkteve të naftës dhe duke përcaktuar rrugët e nevojshme procedurale për të përballuar çdo mungesë serioze të tregut me këto produkte.

Realizimi i këtij objektivi mund të kryhet duke përafruar legjislacionin vendas me direktivën e BE-së dhe bashkëpunimin me vendet anëtare të BE-së, nënshkruese të SKE-së, të cilat kanë tashmë eksperiencë shumëvjeçare në hartimin dhe zbatimin e legjislacionit për rezervat emergjente.

Përmbushja e kërkesave sa lidhet me rezervat e sigurisë do të realizohet gradualisht në bazë të Planit të Veprimit, deri sa shuma e përgjithshme e rezervave të sigurisë në Republikën e Shqipërisë të jetë të paktën **90 ditë mesatare ditore të importeve neto ose të paktën 61 ditë të mesatare ditore të sasisë së konsumit të brendshëm**, cilado nga dy sasitë është më e madhe.

Mesatarja ditore e importeve neto llogaritet në bazë të ekuivalentimit në naftë bruto të importeve të produkteve energjetike hidrokarbure gjatë vitit paraardhës kalendarik.

Mesatarja ditore e konsumit të brendshëm llogaritet në bazë të ekuivalentimit në naftë bruto të produkteve energjetike hidrokarbure me konsumimin e brendshëm gjatë vitit paraardhës kalendarik.

.

Përshkrimi i opsioneve të shqyrtuara

- *Përshkruani opsionin e status quo-së.*
- *Identifikoni dhe përshkruani të gjitha opsionet e politikave që keni marrë parasysh.*
- *Shpjegoni se si janë zgjedhur opsionet e renditura.*

Opsioni 0 – Status quo-ja:
Nëse mbetemi në situatën aktuale, pra me vazhdimin e zbatimit të ligjit ekzistues në fuqi nr. 9876, datë 14.02.2008 “Për prodhimin, transportimin dhe tregtimin e biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, për transport”, i ndryshuar, atëherë kjo do të thotë se nuk do të merret në konsideratë nevoja për harmonizimin e kuadrit ligjor shqiptar me Direktivën 2018/2001/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 11 dhjetor 2018, “Mbi promovimin e përdorimit të energjisë nga burimet e energjive të rinovueshme”, sa lidhet me aktivitetin e prodhimit dhe përdorimit të biokarburanteve në sektorin e transportit.

Gjithashtu, realizimi i objektivit kërkon edhe plotësimin e kriterëve të qëndrueshmërisë së prodhimit të biokarburanteve, të cilat shoqërohen me kosto shtesë për shoqëritë, dhe pa ndërhyrjen qeveritare, shoqëritë do të priren shumë që të shmangin kërkesat e qëndrueshmërisë për të shmangur kostot shtesë. Në këto kushte, nëse nuk nxjerrim ligje për të detyruar aktorët e tregut që të marrin masa të caktuara, realizimi i objektivit të politikës është i pamundur. Ky opsion nuk ka kosto të shtuara në buxhet dhe nuk kërkon burime njerëzore për realizimin e tij, por nuk zgjidh problematikat e identifikuar, duke mos përmbushur as objektivat e vendosur.

Opsioni 1 (rregullator) – Hartimi i një ligji të ri për rezervën e sigurisë për naftën bruto dhe nënproduktet e saj
Ky opsion parashikon hartimin e një ligji të ri, duke marrë parasysh të gjitha ndryshimet dhe kërkesat e kuadrit ligjor të BE-së, sa lidhet me realizimin e aktivitetit të mbajtjes dhe menaxhimit të rezervave të sigurisë për naftën dhe nënproduktet e saj, mënyrës dhe afateve kohore për raportimin e të dhënave të krijuara nga këto aktivitete në Republikën e Shqipërisë.

Ky opsion bën të mundur specifikimin referuar objektivave vjetorë për krijimin dhe mbajtjen e rezervave të sigurisë tashmë nga një autoritet i dedikuar, si dhe përmbushjen e detyrimit në kuadër të të qenurit anëtar i Komunitetit të Energjisë dhe më tej i Bashkimit Evropian, të përpilimit të raportimeve me të dhëna me bazë mujore, tremujore dhe vjetore.

Avantazhet e hartimit të një ligji të ri:

- Një ligj i ri do të inkurajojë rritjen e efektivitetit të mbajtjes dhe menaxhimit të rezervës së sigurisë nëpërmjet Autoritetit që do të krijohet enkas për këtë proces dhe të reagimit nga shteti shqiptar në rast të situatave të jashtëzakonshme të furnizimit të tregut vendas me naftë e nënproduktet e saj.
- Hartimi i një ligji të ri në përputhje me legjislacionin e BE-së do të forcojë pozitat e Shqipërisë në procesin e integritetit evropian.
- Një kuadër ligjor i qartë do të tërheqë aktorët në sektorin e hidrokarbureve për të kryer detyra të cilat mund të delegohen nga autoritetet e përcaktuara në ligj.
- Ligji i ri do të ofrojë një kuadër më të qartë dhe më të kuptueshëm për të gjithë aktorët e sektorit, duke lehtësuar zbatimin e tij dhe duke reduktuar konfuzionin që mund të shkaktojë ndryshimet e shumta në ligjin ekzistues.
- Një ligj i ri do të mundësonte një qasje më të qartë dhe më të strukturuar, duke reduktuar ngarkesën administrative dhe duke përmirësuar menaxhimin e sektorit.

Disavantazhet e këtij opsioni mund të paraqiten në drejtim të:

- Kostove të zbatimit të ri: Megjithatë, zbatimi i ligjit të ri do të sjellë edhe kosto, duke qenë se do të kërkojë burime financiare për trajnimin e punonjësve, për zhvillimin, miratimin dhe zbatimin e tij, të paktën për një periudhë tranzitore, sa të krijohet dhe konsolidohet Autoriteti i Rezervës së Sigurisë. Megjithatë, këto kosto do të kompensohen nga përfitimet e qartësisë ligjore dhe efektivitetit që do të ofrojë ky ligj në krahasim me opsionin e ndryshimit të ligjit ekzistues.
- Zbatimit dhe monitorimit: Një nga sfidat kryesore do të jetë zbatimi efektiv i ligjit dhe monitorimi i përmbushjes së objektivave, sidomos nga operatorët e tregut hidrokarbur.

Opsioni 2 (ndryshimi i ligjit aktual) – Kryerja e ndryshimeve në ligjin aktual në fuqi nr. 8450, datë 24.02.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar. Ndryshimi i ligjit ekzistues do të krijonte paqartësi të konsiderueshme, pasi në ligjin ekzistues çështja e rezervës së sigurisë përfaqësohet vetëm nga një nen.

Duke qenë se direktiva e BE-së, sa i takon aktivitetit të mbajtjes dhe menaxhimit të rezervave të sigurisë, do të transpozohet në 100% të saj, dhe ndryshimet që do të bëheshin në ligjin aktual do të ishin të konsiderueshme nga ana e teknikës legjislative, nuk do të ishte efikase kryerja e ndryshimeve dhe, për rrjedhojë, e pamundur ndërmarrja e një nisme të tillë.

Ndryshimet do të tentojnë të sqarojnë disa norma që aktualisht janë të paqarta ose jo koherente, duke përmirësuar kështu zbatimin e ligjit dhe duke rritur efikasitetin në aktivitetin e mbajtjes dhe menaxhimit të rezervës së sigurisë.

Ligji aktual është i mangët në aspektin e akteve nënligjore, të cilat janë të nevojshme për zbatimin e tij. Ndryshimet do të kërkojnë krijimin e këtyre akteve për të plotësuar boshllëqet dhe për të garantuar funksionimin e duhur të sistemit.

Ky opsion paraqet disa sfida të konsiderueshme, siç janë:

- Konfuzioni në zbatim. Një nga shqetësimet kryesore me këtë opsion është se ndryshimet në ligjin aktual mund të krijojnë konfuzion në zbatim, pasi shumë norma nuk janë më të koherente me njëra-tjetrën. Kjo do të mund të çonte në interpretime të ndryshme dhe probleme në aplikimin praktik të ligjit.
- Ligji aktual ka shumë boshllëqe, veçanërisht në lidhje me aktet nënligjore, dhe ndryshimi i tij nuk do të jetë efikas pa krijimin e një kuadri të plotë ligjor. Kjo situatë do të kërkonte ndryshimin e 100% të ligjit ekzistues, duke e bërë procesin më të komplikuar dhe, në kuadër të teknikës legjislative, të pamundur.
- Rreziku i joefikasitetit. Ndryshimi i ligjit aktual mund të rezultojë në një kornizë ligjore që nuk është mjaft efikase për të adresuar nevojat e sektorit energjetik hidrokarbur, duke bërë që qëllimet e përcaktuara për zhvillimin e këtij sektori të mos arrihen. Një ligj që përmban shumë ndryshime të nevojshme, por që mbetet i fragmentuar, do të ndihmojë pak në përmirësimin e situatës.

Avantazhet e ndryshimit të ligjit:

- Realizimi i kërkesave të BE-së. Ky opsion mund të sigurojë që Shqipëria të përmbushë angazhimet e saj ndaj BE-së, duke e bërë atë një hap të rëndësishëm në procesin e integritetit evropian.
- Ndryshimi i ligjit do të ofronte mundësinë për të rimëkëmbur dhe përmirësuar disa nga normat e tij, duke e bërë atë më të përshtatshëm për realitetin aktual të sektorit.

Sa më sipër, ndryshimi i ligjit aktual për rezervën e sigurisë përbën një opsion që, edhe pse ka përfitime të caktuara, është i shoqëruar me shumë sfida dhe rreze. Konfuzioni që mund të krijohet nga ndryshimet e shumta në një ligj ekzistues që nuk është plotësisht koherent mund të çojë në vështirësi në zbatim dhe mund të pengojë zhvillimin efektiv të sektorit të biokarburanteve.

Opsioni 3 (hartimi dhe miratimi i akteve nënligjore në zbatim të ligjit në fuqi):

Miratimi i akteve nënligjore nuk është i favorshëm, për shkak se ky opsion nuk do të bënte të mundur përafrimin e legjislacionit të Bashkimit Evropian, pasi autorizimet ligjore për nxjerrjen e akteve nënligjore janë të bazuara në një direktivë të shfuqizuar nga Bashkimi Evropian. Gjithashtu, miratimi vetëm i akteve nënligjore nuk do të nxiste tregun për mbajtjen dhe menaxhimin e rezervave të sigurisë, pasi në tërësi ligji aktual ka të përcaktuar metodikën e llogaritjes së rezervave të sigurisë, e cila nuk është sipas legjislacionit evropian në fuqi. Më tej, modeli i mbajtjes së rezervave të sigurisë nga industria, i cili edhe kështu si është, ka probleme dhe ka humbur koherencën e vet.

Opsioni 4 – Jo-rregullator:

Një opsion jo-rregullator për zgjidhjen e problematikave, ku nuk është përcaktuar detyrimi për mbajtjen dhe menaxhimin e rezervave të sigurisë në sasi dhe lloje burimesh energjetike, nuk mund të realizohet. Kjo referuar eksperiencës së të gjitha vendeve të BE-së, dhe nuk ka asnjë argument financiar për të mbështetur këtë opsion.

Megjithatë, ky opsion paraqet disavantazhe kundrejt opsionit të hartimit të ligjit të ri, pasi opsioni jo-rregullator mbështetet kryesisht në ndërgjegjësimin e të gjithë aktorëve dhe faktorëve të tregut hidrokarbur, i cili nuk është i detyrueshëm.

Nga ana tjetër, do të mbeteshin të paezauruara kërkesat ligjore të Bashkimit Evropian.

Vlerësimi i opsioneve/analizimi i ndikimeve

- *Identifikoni se kush preket.*
- *Identifikoni llojet e ndikimeve për secilin grup të prekur; bëni dallimin midis ndikimeve të drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta.*
- *Për ndikimet e drejtpërdrejta:*
 - *Përshkruani nga ana cilësore ndikimet e drejtpërdrejta mbi grupet e prekura. o Analizoni nga ana sasiore ndikimet më të rëndësishme të drejtpërdrejta. o Përcaktoni vlerën monetare të ndikimeve më të rëndësishme të drejtpërdrejta aty ku është e mundur (shih aneksin I/a për tabelën që mund të përdorni).*
 - *Analizoni ndikimin mbi ndërmarrjet e vogla dhe të mesme.*
- *Për ndikimet jo të drejtpërdrejta:*

- *Përshkruani nga ana cilësore ndikimet jo të drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.*
- *Analizoni ndikimin mbi konkurrencën.*
- *Diskutoni kufizimin e analizës:*
 - *Jepni supozimet në të cilat janë bazuar parashikimet dhe risqet, të cilave ato u nënshtrohen.* ○ *Tregoni sa të forta, të pavarura dhe të rëndësishme janë provat që mbështesin supozimet.*
 - *Tregoni se çfarë mund të pengojë realizimin e përfitimeve, të rrisë kostot ose të sjellë pasoja të papritura.*
- *Përmbledhni vlerësimin e opsioneve:*
 - *Paraqisni një pasqyrë përmbledhëse të të gjitha ndikimeve të opsioneve të analizuara.* ○ *Shpjegoni se si ndikimet e të gjitha opsioneve të analizuara krahasohen me njëra-tjetrën.*
 - *Paraqisni përlogaritjet më të mira të përgjithshme neto të ndikimit me vlerë monetare të përcaktuar për çdo opsion (shih aneksin 1/b për tabelën që mund të përdorni).*

Grupet e prekura nga kjo politikë do të jenë:

1. Operatorët që operojnë në sektorin e rafinimit dhe tregtimit të naftës bruto dhe nënprodukteve të saj.
Në varësi të problematikës, ligji ka parashikuar që Autoriteti dhe strukturat përkatëse shtetërore të delegojnë detyra sipas përcaktimeve të ligjit.
2. Shoqatat dhe grupet e interesit të industrisë së hidrokarbureve.
Shoqatat që përfaqësojnë operatorët e sektorit hidrokarbur mund të kenë rol në përjasjen dhe publikimin e masave të reja dhe përshtatjen e industrisë me këto rregullore.
3. Institucionet publike:
 - Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë: Përgjegjëse për hartimin dhe ndjekjen e zbatimit të politikave në sektorin e garantimit të furnizimit me burime energjetike të tregut vendas dhe lidhjen e saj me vendet e rajonit dhe të BE-së në tërësi.
 - Ministria e Financave: Për hartimin dhe miratimin e paketave të përshtatshme ligjore në sistemin fiskal në Republikë.
 - Autoriteti për Rezervën e Sigurisë: Përgjegjës për krijimin, mbajtjen dhe përdorimin e rezervave të sigurisë, përpilimin e raporteve me të dhënat të mbledhura nga veprimtaria në tregun hidrokarbur dhe informimin e strukturave përkatëse vendase dhe të BE-së me to.
 - Inspektorati Shtetëror: I specializuar për kontrollin e veprimtarisë së ushtruar nga personat juridikë, në përputhje me masat e vendosura.
 - Drejtoria e Përgjithshme e Doganave: Përgjegjëse për dërgimin e informacioneve për aktivitetin e të gjithë operatorëve në industrinë hidrokarbure, si dhe për grumbullimin e detyrimeve financiare sipas modelit të përcaktuar.
 - INSTAT: Përgjegjës për informimin e strukturave që përcaktohen në këtë ligj me të dhëna të detajuara që lidhen me bilancin energjetik në Republikën e Shqipërisë.
 - Sektori privat:
 - Kompanitë që realizojnë aktivitetin e prodhimit dhe importit të naftës dhe nënprodukteve të saj, të cilat detyrohen me pagimin e tarifave përkatëse dhe informimin e institucioneve me të dhëna mbi bazë mujore për aktivitetin tregtar në tërësi, sipas metodikave të përcaktuara.

4. Qytetarët:

- Përdoruesit e mjeteve të transportit.

Ndikimet pozitive nga kjo politikë lidhen me përafrimin e legjislacionit të Bashkimit Evropian, rregullimin e tregut sa i takon garantimit të furnizimit me burime energjetike me bazë hidrokarbure për tregun vendas dhe atë rajonal.

Kosto për sektorin publik:

- Do të ketë fonde të dedikuara për mbulimin e shpenzimeve për krijimin, ruajtjen, mirëmbajtjen, inspektimin e rezervave të sigurisë, si dhe për aktivitetet e tjera të rregullta të autoritetit.
- Sigurimi i fondeve do të kërkojë, ndër të tjera, vendosjen e tarifës që do të aplikohet mbi sasi të produkteve energjetike hidrokarbure. Kjo do të sjellë rritje të vlerës në zinxhirin e ngarkesës financiare dhe rezultatin final të çmimit të shitjes të konsumatori.
- Kostot për rritjen e kapaciteteve të burimeve njerëzore dhe infrastrukturës për mundësimin e zbatimit të kësaj politike.
- Përshtatja me kërkesat e reja do të kërkojë ndryshime në sistemet e IT-së për të menaxhuar lejet/autorizimet dhe regjimet standarde, si dhe për të mbledhur dhe përpunuar të dhënat nga bizneset.
- Mbledhja dhe përpunimi i të dhënave të paraqitura nga bizneset.
- Kryerja e inspektimeve nga Ministria, ARS, Inspektorati Shtetëror përgjegjës dhe strukturat përgjegjëse për monitorimin e çështjeve praktike që lidhen me mbajtjen dhe menaxhimin e rezervave të sigurisë. Kostot operacionale të inspektimeve për të përmbushur detyrimet që rrjedhin nga ky ligj nuk mund të përcaktohen tani, sepse çështjet që lidhen me inspektimet do të përcaktohen në aktet nënligjore që do të miratohen për zbatimin e këtij ligji.

Kosto për bizneset:

- Sikurse u përmend më lart, për sigurimin e financimit të krijimit dhe realizimit të detyrave të tjera që do të kryhen nga autoriteti dhe strukturat e tjera përkatëse, do të vendoset një tarifë mbi sasi të produkteve energjetike hidrokarbure që i nënshtrohen detyrimit për pagimin e taksës së akcizës, në përputhje me Ligjin Nr. 61/2012, datë 24.05.2012 “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.
- Kjo do të ndikojë në çmimin final të shitjes së nënprodukteve në tregun vendas.

Ndikimet ekonomike:

- Pritet që në vend të hapen vende të reja pune që lidhen me zhvillimin e këtij sektori.
- Ndikime pozitive do të ketë edhe në konkurrencën në treg për tregtimin e karburanteve, duke sjellë uljen e çmimit të tyre.

Kostot për sektorin publik përfshijnë:

- Kostot e lidhura me kalimin drejt paraqitjes së kërkesave të reja, p.sh., ndryshime në sistemet e TI-së për të menaxhuar mbledhjen e informacionit, përpunimin e të dhënave dhe hartimin e raportimeve sipas standardeve të BE/SKE.

Ndikimet mjedisore:

- Do të ketë ndikim pozitiv për sa kohë do të vendosen rregulla më të qarta dhe monitorim më specifik sa lidhet me çështjet e mbajtjes dhe menaxhimit të rezervës së sigurisë.

Ndikimet sociale:

- Prodhimi i shtuar i biokarburanteve shqiptare do të krijojë vende të reja pune në sektorin publik dhe privat, për sa kohë do të kërkohen punonjës më të specializuar në këtë proces.

- ☐ Zgjidhni opsionin e preferuar, bazuar në analizë. ☐ Shpjegoni arsyetimin tuaj.

Nga shqyrtimi i secilit opsion, konsiderojmë se Opsioni 1, për hartimin dhe miratimin e një ligji të ri, është opsioni i preferuar, pasi:

- Ligji i ri do të inkurajojë rritjen e efektivitetit të mbajtjes dhe menaxhimit të rezervës së sigurisë nëpërmjet Autoritetit që do të krijohet enkas për këtë proces dhe të reagimit nga shteti shqiptar në rast të situatave të jashtëzakonshme të furnizimit të tregut vendas me naftë dhe nënproduktet e saj.
- Duke qenë në përputhje me legjislacionin e BE-së, do të forcojë pozitat e Shqipërisë në procesin e integritetit evropian.
- Do të ofrojë një kuadër më të qartë dhe më të kuptueshëm për të gjithë aktorët e sektorit, duke lehtësuar zbatimin e tij dhe duke reduktuar konfuzionin që mund të shkaktojnë ndryshimet e shumta në ligjin ekzistues, si dhe do të tërheqë aktorët në sektorin e hidrokarbureve për të kryer detyra që mund të delegohen nga autoritetet e përcaktuara në ligj.
- Do të mundësojë një qasje më të qartë dhe më të strukturuar, duke përmirësuar menaxhimin e sektorit.

Për të kryer një shqyrtim më të mirë të opsioneve të marra në konsideratë, është kryer edhe analiza me shumë kritere.

Opsionet e shqyrtuara janë:

- Opsioni 0 – Status quo-ja
- Opsioni 1 (rregullator) – Hartimi dhe miratimi i një ligji të ri
- Opsioni 2 – Ndryshimi i ligjit aktual
- Opsioni 3 – Hartimi dhe miratimi i akteve nënligjore në zbatim të ligjit në fuqi
- Opsioni 4 – Jo-rregullator

Kriteret që tregojnë arritjen e objektivit për të realizuar qëllimin e nismës:

- Përafrimi me legjislacionin evropian
- Krijimi i rezervave të sigurisë gradualisht në bazë të Planit të Veprimit, deri sa shuma e përgjithshme e rezervave të sigurisë në Republikën e Shqipërisë të jetë të paktën:
 - 90 ditë mesatare ditore të importeve neto, ose
 - 61 ditë të mesatares ditore të sasisë së konsumit të brendshëm, cilado nga dy sasitë është më e madhe
- Mesataret ditore të importeve neto dhe konsumit të brendshëm, siç përmendet në atë pikë, do të përcaktohen për periudhën nga 1 janari deri më 30 qershor të çdo viti kalendarik, në bazë të sasive të importuara ose të konsumuara gjatë vitit të fundit, por para një viti kalendarik në fjalë
- Hartimi i Planit Kombëtar të Reagimit për përdorimin e rezervave të sigurisë në rast të reduktimit të papritur deri në mungesë të furnizimit të tregut me nënprodukte të naftës bruto
- Autoriteti përgatit raport vlerësues për zbatimin e këtij ligji brenda 24 muajve nga hyrja në fuqi. Raporti dorëzohet pranë Ministrit dhe të dhënat e agreguara publikohen.

Pesha e kriterëve sipas rëndësisë relative:

- Përafrimi me legjislacionin evropian – ()
- Krijimi i rezervave të sigurisë – ()
- Përdorimi i rezervave të sigurisë – ()
- Raportimi – ()

Zgjedhim shkallën e performancës nga 0 tek 5 ku 0 përfaqëson opsionin më pak të preferuar dhe 5 atë më të preferuarin.

Kriteret	Pesha	Opsioni 0	Opsioni 1	Opsioni 2	Opsioni 3	Opsioni 4
Përafrimi i legjislacionit evropian	5					
Krijimi rezervave të sigurise	5					
Perdorimi rezervave të sigurise	4					
Raportimi	3					
Pikët						

Nga vlerësimi me shumë kriteret i bërë më sipër, opsioni i preferuar duke marrë parasysh kriteret, është opsioni nr. 1, pasi kriteret mund të përmbushen më me efikasitet dhe shpejtësi.

Çështje të zbatimit

- *Shpjegoni se cila njësi do të jetë përgjegjëse për zbatimin e opsionit të zgjedhur.*
- *Shpjegoni pengesat e mundshme për zbatimin e opsionit të zgjedhur.*
- *Përshkruani masat që do të ndërmerren gjatë zbatimit për të arritur qëllimet e politikës.*
- *Specifikoni të gjitha kërkesat e përputhshmërisë dhe të zbatimit.*

Për të mundësuar zbatimin e këtij ligji, do të angazhohen disa institucione si: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave, Autoriteti për Rezervën e Sigurisë, Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, dhe INSTAT.

Me hyrjen në fuqi të ligjit të ri, këto institucione do të kenë për detyrë hartimin dhe miratimin e një numri aktesh nënligjore për çështjet e mëposhtme:

- Metodatat e llogaritjes, përbërja e rezervave të sigurisë dhe procedurat për mbajtjen e rezervës minimale të sigurisë për naftën dhe/ose nënproduktet e saj.
- Metodologjia e grumbullimit, ruajtjes, përpunimit të të dhënave, forma dhe mënyra e paraqitjes së tyre, si dhe mënyrat e raportimit.
- Plani i veprimit për krijimin e rezervave të sigurisë.
- Krijimi, mënyra e funksionimit dhe kompetencat e detajuara të ARS.
- Krijimi dhe mbajtja e rezervave specifike.
- Plani Kombëtar i Reagimit.

Këto akte nënligjore do të përcaktojnë detajet e zbatimit. Mekanizmat institucionalë që kërkohen për zbatimin e këtij ligji përfshijnë:

- Detyrimin për raportimin mujor të aktivitetit.
- Raportimet nga institucionet përkatëse drejtuar strukturave shtetërore vendase dhe ndërkombëtare.
- Krijimi dhe funksionimi i ARS.
- Vendosja e tarifave dhe, nëse është e nevojshme, procedura për mënyra të tjera financimi të Autoritetit.
- Përmbytja e detyrave të lëna për ARS, operatorët dhe aktorët e tjerë të përfshirë në këtë proces.
- Monitorimi për garantimin e cilësisë së produkteve, etj.

Pengesa të mundshme:

- Rezistenca nga operatorët, për shkak të kostove më të ulëta që kanë pasur më parë.
- Vonesa/mosmiratimi në kohë i akteve nënligjore të parashikuara në projektligj.
- Nevoja për kapacitete të duhura të burimeve njerëzore dhe infrastrukturës përkatëse për realizimin e masave.

Faza e shqyrtimit/vlerësimit

- *Jepni një përshkrim të përmbledhur të masave të monitorimit dhe të vlerësimit.*
- *Identifikoni kriteret/treguesit për të matur arritjen e qëllimeve ose progresin drejt tyre.*

Mekanizmat institucionalë që kërkohen për zbatimin e këtij ligji përfshijnë:

- Detyrimin për raportimin, përlllogaritjen e detyrimeve për vitin vijues dhe kontrollin e zbatimit të detyrimeve që lidhen me sasinë e rezervës së sigurisë, pa kufizuar përmbytjen e kriterëve dhe të cilësisë së tyre.
- DPD dhe INSTAT bashkëpunojnë me Autoritetin dhe shkëmbejnë informacionin sa lidhet me të dhënat e kërkuara dhe pagesat e tarifave.

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) do të jetë përgjegjëse për koordinimin dhe bashkëpunimin me Komisionin Evropian dhe Sekretariatit të Energjisë, sa lidhet

me zbatimin e dispozitave të këtij ligji, veçanërisht për çështjet e sigurisë së furnizimit me produkte energjetike hidrokarbure në vendet e Komunitetit të Energjisë, si dhe për raportimin mbi gjendjen e rezervave të detyrueshme të Shqipërisë.

Monitorimi për zbatimin e dispozitave të këtij ligji dhe të marrëveshjeve për depozitimin dhe përtëritjen e rezervave të sigurisë kryhet nga MIE dhe Autoriteti.

Në rast të ndërprerjes së furnizimit të tregut me nënproduktet e naftës bruto, MIE i propozon Këshillit të Ministrave ndërmarrjen e një vendimi për përdorimin e rezervave të sigurisë, në përputhje me Planin Kombëtar të Reagimit sipas këtij ligji.

Me këtë iniciativë ligjore janë parashikuar dy tregues themelorë:

1. Rezervat e sigurisë krijohen gradualisht në bazë të Planit të Veprimit, deri sa shuma e përgjithshme e rezervave të sigurisë në Republikën e Shqipërisë të jetë:

- të paktën 90 ditë mesatare ditore të importeve neto, ose
- të paktën 61 ditë të mesatare ditore të sasisë së konsumit të brendshëm, cilado nga dy sasi të është më e madhe.

Mesataret ditore të importeve neto dhe konsumit të brendshëm do të përcaktohen për periudhën nga 1 janari deri më 30 qershor të çdo viti kalendarik, në bazë të sasive të importuara ose të konsumuara gjatë vitit të fundit, por para një viti kalendarik në fjalë.

2. Autoriteti përgatit raport vlerësues për zbatimin e këtij ligji brenda 24 muajve nga hyrja në fuqi.

Raportime të tjera do të realizohen nga strukturat përkatëse sipas afateve të përcaktuara në këtë ligj dhe aktet nënligjore që do të dalin në zbatim të tij.

Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca 2/a

Tabela: Vlera aktuale neto në total (VAN) - kostot dhe përfitimet me vlerë monetare të përcaktuar në milionë lekë e zbritur për 10 vjet (Vlera aktuale e kostos dhe vlera aktuale e përfitimit); krahasuar me status quo-në.

Në këtë fazë të politikës, nuk përllogariten kostot në mënyrë sasiore, pasi politika e propozuar bën të mundur rregullimin e përgjithshëm të kësaj fushe dhe të aktivitetit të rezervës së sigurisë për naftën dhe nënproduktet e saj në përgjithësi.

Plotësimet e mëvonshme, me akte nënligjore si dhe me akte ligjore në përputhje me legjislacionin e Bashkimit Evropian, mund të përcaktojnë kostot në mënyrë konkrete.

	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Viti 6	Viti 7	Viti 8	Viti 9	Viti 10
Faktori zbritës										
Kosto për buxhetin – një herë										
Kosto për buxhetin – në vazhdim										
Kosto për biznesin – një herë										
Kosto për biznesin – në vazhdim										
Kosto për grupet e tjera – një herë										

Kosto për grupet e tjera – në vazhdim										
Kosto në total										
Kosto e zbritur në total = Kosto në total x faktorin zbritës										
Përfitimi për buxhetin – në vazhdim										
Përfitimi për biznesin – një herë										
Përfitimi për biznesin – në vazhdim										
Përfitimi për grupet e tjera – njëherë										
Përfitimi për grupet e tjera – në vazhdim										
Kosto për buxhetin – në vazhdim										
Përfitimi në total										
Përfitimi i zbritur në total = Përfitimi në total x faktorin zbritës										
Vlera aktuale e kostos në total										
Vlera aktuale e përfitimit në total										
Vlera aktuale neto (VAN) = Vlera aktuale e përfitimit në total – Vlera aktuale e kostos në total										

Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca 2/b

Tabelë: Vlera aktuale neto në total e çdo opsioni

Opsioni	Vlera aktuale në milionë lekë		Vlera aktuale neto në milionë lekë
	Kosto	Përfitimi	
Opsioni 1			
Opsioni 2			